



Pranuar / Dorezuar Primljen/Prodato Received/Delivety	13.04	2022	2	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKDPMSHCK	2082/2022		1/3	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.194/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.194/2021 të datës 01.03.2022 të parashtruar nga

me adresë banim:
kundër organit të punësimit/Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 13.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.194/2022 e datës 01.03.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Agjencinë për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve (KIESA) më datë 01.03.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1091/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensimin e ndryshimit në pagë për periudhën nga data 06.06.2017 deri më datë 31.09.2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.03.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa kjo e fundit me datë 17.03.2022 ka përcjell shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 194/2022 të datës 01.03.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Rishpalljen e konkursit me Nr. Ref MTI/12 të datës

25.04.2017; Ndryshim dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit të datës 01.10.2019; Njoftimin me numër të protokollit 850 të datës 05.06.2017 për kandidatin e suksesshëm; E-malin e datës 09.07.2017; Aktgjykimin me numër A.nr.1264/2017 të datës 27.08.2019; Vendimin me numër të protokollit 3134/2017 të datës 26.06.2017; Raportin e datës 23.06.2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën me numër të protokollit 2559 të datës 23.12.2019; Kërkesën me numër të protokollit 1218/2022 të datës 07.03.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 1432/2022 të datës 17.03.2022; E-mailin e datës 03.07.2017; Njoftimin me numër të protokollit 990 të datës 03.07.2017; E-malin me numër të protokollit 1923/2022 të datës 06.04.2022;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat materiale, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pabazuar sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesi kishte aplikuar në Konkursin e publikuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë me datë 25.04.2017 për pozitën e punës Udhëheqës i Sektorit të Zonave Ekonomike në kuadër të Agjencisë për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve. I njëjti bazuar në vlerësimin e Komisionit Përzgjedhës ishte rekomanduar si kandidati me i suksesshëm për këtë pozitë.

Me tej, Kolegji verën së proceduara e rekrutimit për pozitën e punës Udhëheqës i Sektorit për Zhvillimin e Zonave Ekonomike ishte vëzhguar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, i cili përmes Vendimit Nr.90/2017 të datës 23.06.2017 kishte rekomanduar anulimin e procedurës së rekrutimit për pozitën e punës Udhëheqës i Sektorit për Zhvillimin e Zonave Ekonomike me arsyetimin së procedura e rekrutimit ishte zhvilluar në kundërshtim me legjislacionin e shërbimit civil. Konform këtij Vendimi organi i punësimit gjegjësisht Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka anuluar Konkursin për pozitën Udhëheqës i Sektorit për Zhvillimin e Zonave Ekonomike.

Kundër Vendimit të Këshillit Nr.90/2017 të datës 23.06.2017 dhe numër protokollit 3134/2017 të datës 23.06.2017, ankuesi ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, e cila me Aktgjykimin A.nr.1264 /17 të datës 10.06.2019 ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit në këtë rast ankuesit, dhe ka anuluar vendimin e Këshillit numër protokollit 3134/2017 të datës 23.06.2017 duke kthyer çështjen në rivendosje nga Këshilli. Mirëpo në mungesë të anëtarëve Këshilli nuk ka qenë funksional dhe nuk ka rishqyrtuar çështjen në fjalë brenda afatit ligjor sipas aktgjykimit, ndërsa Gjykata Komunale me datë 27.08.2019 ka bërë të plotfuqishëm Aktgjykimin Nr.1264 /17 të datës 10.06.2019. Komform këtij aktgjykimi, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në emër të ankuesit ka lëshuar Ndryshim dhe Plotësimin e Akt Emërimit të datës 01.10.2019 për pozitën e punës Udhëheqës i Sektorit për Zhvillimin e Zonave Ekonomike, me koeficient 8.5 të pagës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në provat e lëndës, konstaton së ankuesja pas anulimit të procedurës së rekrutimit sipas Vendimit të Këshillit Nr.90/2017 të datës 23.06.2017 ka ushtruar pozitën e Zyrtarit për Pranim të Mallit dhe meqenëse më Aktgjykimin Nr.1264/17 të datës 10.06.2019 të Gjykatës Themelore nuk është vendos meritore lidhur me kërkesëpadinë e ankuesit gjegjësisht nuk është vërtetuar ligjshmëria e procedurës së përzgjedhjes së ankuesit në pozitën e Udhëheqësit të Sektorit për Zhvillimin e Zonave Ekonomike dhe nuk i është njohur e drejta e kompensimit të ndryshimit në pagë, Kolegji

konstaton së është i pabazuar pretendimi ankimor i ankuesit që ti behet kompensimi i ndryshimit të koeficientit nga 7.5 ne 8.5 për periudhën nga data 06.06.2017 deri më datë 31.09.2019.

Po ashtu Kolegji në funksion të shqyrtimit të pretendimeve ankimore në ankesë ju referua nenit 19 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin është përcaktuar se: *E drejta e pagës dhe shpërblimit të drejtë Zyrтари publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagë, si dhe nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, ku theksohet se: Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara në aktin e kontratës së punës”, si rrjedhojë meqenëse me asnjë akt juridik nuk është vërtetuar krijimi i marrëdhënies së punës së ankuesit në pozitën e Udhëheqësit të Sektorit për Zhvillimin e Zonave Ekonomike për periudhën nga 06.06.2017 deri më datë 31.09.2019, apo që i njëjti sipas vendimit të organit të punësimit ka ushtruar pozitën e Udhëheqësit të Sektorit për Zhvillimin e Zonave Ekonomike për periudhën në fjalë, atëherë, mbi këtë konstatim rezulton se nuk mund te bëhet asnjë lloj kompensimi për periudhën gjatë së cilës ankuesi nuk ka ushtruar pozitën e Udhëheqësit të Sektorit për Zhvillimin e Zonave Ekonomike.*

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 dhe 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.194/2021

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj- Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Udhëheqësit së Burimeve në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.